

VENDIM
Nr.686, datë 18.6.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN E DREJTËSISË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 1278, datë 23.12.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Shkenca juridike civile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

b) Doktoratë në “Shkencat penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

c) Doktoratë në “E drejta publike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. *Kuotat e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, për vitin 2009, janë gjithsej 75, prej të cilave 15 për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë vendit. Ndarja e këtyre kuotave, sipas programeve të studimeve, është si më poshtë vijon:*

<i>a) Doktoratë në “Shkencat juridike civile”</i>	<i>25</i>
<i>kuota;</i>	

<i>b) Doktoratë në “Shkencat penale”</i>	<i>25</i>
<i>kuota;</i>	

<i>c) Doktoratë në “E drejta publike”</i>	<i>25</i>
<i>kuota.</i>	

4. Mënyra e plotësimit të kuotave, që mbeten të paplotësuara në një program studimi, përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. *Tarifa e shkollimit për këto programe studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës.*

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha